



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 17.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të datës 02.04.2019.
2. Seancë dëgjimore me kandidatët: Pajtim Melani, Ervin Mete, Olsi Coku për plotësimin e vakancës Kryetar në Bordin e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Dritan Bici, Evis Kushi, Ervin Bushati, Senida Mesi dhe Arben Elezi.

Mungojnë:

Anastas Angjeli, Vullnet Sinaj dhe Ambra Barova.

Të ftuar:

Pajtim Melani

Ervin Mete

Olsi Çoku

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave.

Sot në rendin e ditës së këtij komisioni kemi miratimin e procesverbalit të datës 02.04.2019.

A ka ndonjë koment apo pyetje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet procesverbali,

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi seancën dëgjimore me kandidatët: Olsi Çoku, Pajtim Melani dhe Ervin Mete për plotësimin e vakancës kryetar në Bordin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Fillojmë me zotin Olsi Çoku.

Zoti Çoku, keni në dispozicion 5 deri në 7 minuta kohë për të bërë prezantimin tuaj.

Olsi Çoku – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ekonomisë,

Jam këtu për të prezantuar kandidaturën time për pozicionin e kryetarit të Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Unë dua të ndalem në dy momente: së pari, dua të tregoj eksperiencën time financiare në përmbushje të kriterëve ligjore të parashikuara në ligjin “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”.

Studimet i kam mbaruar në vitin 2008 dhe menjëherë kam filluar punë si jurist, fillimisht në Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë dhe, më pas, në një institucion shtetëror, ku kam mbajtur pozicionin e drejtorit Juridik në Agjencinë Kombëtare të Turizmit deri në vitin 2012. Prej vitit 2012 deri më sot punoj në një studio ligjore të quajtur “Optima Legal end Financial”, ku i kam ngjitur të gjitha shkallët e karrierës, që nga gradimet fillestare derisa prej një viti e gjysmë jam bërë partner në këtë zyrë.

Gjatë kësaj periudhe kam pasur një shkëputje të shkurtër, njëvjeçare, ndërmjet viteve 2013-2014 në bankën “Credins”, ku kam punuar si konsulent juridik kryesisht për disa marrëveshjeje ndërkombëtare të lidhura nga banka, por edhe në proceset e brendshme të kësaj banke.

Ndërkohë, dua të ndalem te përmbushja e kriterit ligjor të eksperiencës sime prej 5 vjetësh në konsulencën për shoqëritë tregtare. Siç e thashë, prej 7 vjetësh punoj në një shoqëri tregtare, në një studio ligjore, që ka si objekt të veprimtarisë së saj pikërisht konsulencën për shoqëritë tregtare. Ndër punët më të rëndësishme që kam bërë gjatë këtyre vjetëve ka qenë edhe ajo e këshilltarit ligjor i dy kompanive ndërkombëtare “Roland Berger” dhe “**Backer Bruckler Head**”, që janë dy kompani konsulence ndërkombëtare, të cilat kanë ndihmuar qeverinë shqiptare gjatë këtyre vjetëve në reformimin e sektorit të gazit natyror. Gjatë kësaj periudhe kemi themeluar edhe dy sh.a shtetërore, si “Albgaz sh.a” dhe “Joint Venture” ndërmjet “Albgas”-it dhe “SNAM s.p.a”, të cilat do të merren me mirëmbajtjen e tubacioneve të TAP-it. Gjithashtu, kemi asistuar edhe ERE-n dhe shumë procese të tjera, kryesisht të natyrës tregtare, që kanë të bëjnë me negociimin e kontratave të ndryshme, me qeverisjen e mirë të korporatave të këtyre kompanive sipas standardeve kombëtare, si dhe me certifikimin dhe licencimin e tyre nga institucionet vendase, si: ERE-ja dhe Komuniteti i Energjisë në Vjenë. Ndërkohë, në përmbushje të kriterit ligjor për hartim legjislativ në vitin 2015-2016 jam kontraktuar nga UNICEF-i për të reformuar sistemin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, ku kemi realizuar me sukses hartimin e ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”. Gjatë këtyre vjetëve kam ndihmuar ish-Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë për hartimin e disa akteve nënligjore të ligjit “Për gazin natyror”. Gjithashtu, kam qenë i kontraktuar nga OSBE-ja ku kemi hartuar disa draftvendime dhe draftstrategji kryesisht në fushën e krijimit mjedisor.

Po ashtu kemi asistuar edhe ERE-n, së bashku me kompaninë gjermane “**Backer Bruckler Head**” në hartimin e disa akteve rregullatore, si metodologjia e çmimit të gazit apo mënyra e licencimit të operatorëve të gazit natyror. Ndërkohë, në përditshmërinë time të aktivitetit profesional, unë merrem me këshillimin e shumë kompanive tregtare, që nga operatorët koncensionarë në fushën e energjisë, në sektorin bankar, në organizatën ndërkombëtare e të tjerë.

Duke besuar se kjo retrospektivë e karrierës sime tregon përmbushjen e kriterëve ligjore, madje edhe tejkalimin e tyre, po ndalem pak edhe në platformën për AMF-në.

Nga një hulumtim i veprimtarisë së AMF-së shikoj se në të shkuarën ka pasur shumë probleme, si: mungesë transparence dhe informimi të publikut; edukim të dobët financiar, evidentuar kjo edhe në disa raporte, qoftë nga rezoluta e Kuvendit, por edhe nga raportet e KLSH-së; nuk ka mbrojtje efikase të konsumatorëve, sepse nuk u bëhet e ditur se cilat janë

mjetet ligjore të mbrojtjes së tyre në nënshkrimin e kontratave për policat e sigurimit; ka një bashkëveprim jo të mirë institucional, të treguar edhe në Kuvend, evidentuar kjo edhe nga rezoluta, por edhe me autoritetet e tjera, si Autoritetin e Konkurrencës.

(Diskutime pa mikrofon.)

Ndërkohë, Autoriteti ka çaluar disi edhe në një rol, të cilin ndoshta nuk e ka të parashikuar në mënyrë eksplicite në ligj (por nga përvoja që ka me sektorët e rinj në treg i takon ta bëjë), është që të gjenerojë mundësi të reja financimi dhe pune për operatorët në tregun jobankar, kryesisht në kompanitë e sigurimit, ku hapësirat janë të shumta në legjislacionin në fuqi për të gjeneruar mënyra të reja punësimi me polica sigurimi të detyrueshme apo jo të detyrueshme. Ndoshta ekspertiza ime si jurist në bord pikërisht këtë do të synoj, të shfrytëzoj të gjithë kapacitetin e pashfrytëzuar nga baza ligjore në fuqi, por edhe me ndihmën e Kuvendit, edhe të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë do të shikojmë mundësi për ndryshime ligjore, gjithnjë nëse do të ekzistojë vullneti i duhur. Kështu që për ta bërë këtë besoj se ka nevojë për një qasje të re në menaxhimin e Bordit, pikërisht edhe në ushtrimin e funksionit mbikëqyrës dhe inspektues me operatorët e tregut. Unë preferoj një qasje disi më të integruar me natyrë këshillimore ndaj kompanive të sigurimit, ku natyrisht duhet të evidentohen problemet, por duhet t'i ndihmojmë kompanitë e sigurimit, që të kuptojnë se ku kanë gabuar dhe si mund t'i përmirësojnë gabimet e tyre.

AMF-ja nuk duhet parë si një xhandar që kërkon zbatimin legjislacionit, por më shumë si një partner i kompanive të sigurimit, natyrisht pa toleruar edhe kriteret ligjore nuk përmbushen. Gjithashtu, duhet një transparencë më e madhe në vendimmarrje; përmirësim i bashkëpunimit institucional; si dhe edukim periodik i publikut për tregun e letrave me vlerë ose tregun e kapitaleve.

Bordi ka për detyrë që të marketojë shumë më tepër punën e AMF-së, sepse nga një studim i fundit i kryer na rezulton se vetëm 10% e të anketuarve e njohin se vetëm çfarë bën AMF-ja dhe çfarë mund të bëjë në ndihmesë të publikut. Po ashtu edhe për afrimi i legjislacionit me UE Aquì duhet realizuar sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që edhe AMF-ja të ketë riorganizim të ri institucional dhe më të afërt me rregullat e BE-së. Këtu i referohem edhe mungesës së një departamenti të dedikuar për parandalimin e pastrimit të parave në këtë institucion. Në dijeninë time është vetëm një person i dedikuar, që merret me parandalimin e

pastrimit të parave dhe nuk ka një departament, që të rakordohet me institucionet e tjera qendrore.

Gjithashtu, ka nevojë për hartimin e politikave që gjenerojnë biznes për subjektet e licensuara, duke mos lejuar në të njëjtën kohë edhe rrezikimin e parimeve të mbrojtjes së konsumatorit.

Unë dua të ndalem në tri komponentët e tregut për sigurimet: duhet ushtrimi i një roli proaktiv në monitorim, me qëllim rritjen e vlerave absolute të pagesave bruto ndaj dëmeve, sepse ka një rritje, por raporti vazhdon të mbetet i ulët; ka nevojë për ushtrim të inspektimeve tematike për zbatimin e procedurave të trajtimit të ankesave, kryesisht nga konsumatori në raport me kompanitë e sigurimit dhe anasjelltas, por edhe për informimin parakontraktual të konsumatorëve; ka nevojë të zgjidhet ngërçi me Byronë Kombëtare të Sigurimeve dhe Fondin e Kompensimit, duke menduar një strategji të mirëfilltë ligjore, pikërisht për të adresuar këto probleme, pa goditur kompanitë e sigurimit, por edhe duke mundësuar përmbushjen e misionit ligjor të institucionit.

Po në lidhje me Byronë. Gjithashtu ka nevojë për organizimin e më shumë aktiviteteve dhe dhënien e propozimeve për zhvillimin e mëtejshëm të tregut duke zgjeruar gamën e sigurimeve të detyrueshme nëpërmjet lobimit dhe nismave ligjore.

Për sa i përket tregut të letrave me vlerë, siç e dimë, është një treg që në statusin aktual nuk ka shumë probleme, por mbetet i pazhvilluar. Duke ndërmarrë nisma të reja ligjore dhe duke plotësuar bazën ligjore kryesisht për forcimin e kriterëve të licencimit të subjekteve që operojnë në këtë treg, atëherë, në një fazë të dytë, do të mundemi që tregun ta hapim edhe ndaj titujve private dhe jo thjesht ndaj titujve shtetërorë.

Gjithashtu, ka edhe një problem me miratimin e prospekteve, sepse kjo paketë ligjore do të shkojë bashkë. Pra, kompanitë që emetojnë obligacione kanë përgjegjësinë ligjore që të garantojnë vërtetësinë e prospekte të tyre, por në kuptimin e mbrojtjes së konsumatorit, prospektet duhet që të garantohen edhe nga institucionet. Pra nuk mund të kenë një rol vëzhgues në këtë drejtim, por do të ketë një rol monitorues dhe mbikëqyrës, siç ka edhe me komponentët e tjerë të tregut.

Për sa u përket fondeve dhe pensioneve vullnetare ose suplementare, besoj se është një pikë që vlen të përmendet përtej AMF-së. Sot jemi në një fazë ku skema aktuale e pensioneve, skema e solidaritetit, siç njihet ose shtylla e parë, është disi e komprometuar për shkak të

demotivimit të brezave të rinj për të kontribuar në këtë skemë, për shkak të kthimit pas në kohën e pensionit të një shumë e vogël të ardhurash, por edhe çështja e zvogëlimit të numrit të popullsisë nuk e bën shumë fizibël skemën në të ardhmen. Ne mund të ndjekim shembujt e rajonit, kryesisht të Maqedonisë, që të integrojmë skemën e solidaritetit me shtyllën e dytë, ku një komponent i skemës të financohet nëpërmjet kontributeve private të qytetarëve, në mënyrë që ata të marrin mbrapsht atë që investojnë plus interesat nga kompanitë e sigurimit. Kjo duhet menduar mirë, sepse ndihmon jo vetëm në gjenerimin e biznesit për kompanitë dhe në rolin e AMF-së, por ndihmon edhe buxhetin e shtetit, duke lehtësuar një barrë shumë të madhe.

Për sa u përket paketave të sigurimit të jetës, në ndryshim nga ato të jo jetës, nuk kanë një raportim *oline*, duke e bërë disi më të vështirë edhe mbikëqyrjen.

Këto ishin pak a shumë pikat e mia. Nëse ka pyetje, jam i hapur.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Çoku!

A ka pyetje për zotin Çoku.

Ervin Bushati – Prezantimi ishte shumë interesant. Unë për herë të parë e dëgjoj që 18% e qytetarëve kanë njohuri për rolin dhe të drejtat e tyre. Ne kemi pasur turbulencë sidomos në rimbursimet e aksidenteve apo problemeve që ata kanë nga siguracionet në përgjithësi. Përveç njohjes më shumë të institucionit, si mund të rriten rimbursimet, ndoshta duke përdorur mënyra të reja në teknologji, pra duke bërë direkt si ankimimin, ashtu dhe vendimmarrjen, pra duke përdorur faqe interneti apo aplikacione. A keni ndonjë projekt për këtë, sepse më duket një pikë që duhet të ketë më shumë vendimmarrje si nga qytetarët, por edhe nga grupet e interesit?

Faleminderit!

Olsi Çoku – Për këtë pikë, mendoj se mund të marrim si model Autoritetin Mbikëqyrës Financiar në Itali, i cili ka një faqe interneti spektakolare, ku publikon të gjitha dispozitat kontraktuale që do të lidhen për policat e sigurimit. Pra, ka një portal të dedikuar për ankesat, por edhe informacioni që u jepet qytetarëve është i lexueshëm dhe i kuptueshëm.

Nëse ne shikojmë faqen e internetit të AMF-së, ka një gjuhë shumë teknike që vetëm ekspertët financiarë mund ta kuptojnë. Unë jam jurist dhe merrem në përditshmërinë time me ligje nga më të ndryshmet dhe shpeshherë gjej vështirësi në kuptimin e disa koncepteve për mënyrën sesi janë shkruar.

Në vitin 2008, Dhoma e Lordëve të parlamentit Britanik, ka nxjerr një rezolutë për normat e mbikëqyrjes financiare, ku duhet të lihen mënjanë sasia dhe duhet përmirësuar cilësia

dhe gjuha. Pra, duhet të përdoret një gjuhë e thjeshtë dhe e kuptueshme për publikun, kjo e shoqëruar me disa materiale që mund të publikohen jo vetëm në portalin e institucionit, por edhe nëpër media. Pra AMF-ja duhet të shfrytëzojë më shumë mundësitë e saj për të raportuar dhe për të ndihmuar në perceptimin e publikut dhe duke pasqyruar që në gjenezë të afrimit të një konsumatori, për shembull, një kontratë për marrjen e një shërbimi të një police sigurimi si asaj të jetës, edhe asaj të jo jetës.

Gjithashtu, portali i raportimeve *online*, është një tjetër gjetje që mund të synohet, ndërkohë që për zgjidhjen e konflikteve mund të marrim modelin hungarez që ka një bord të arbitrazhit financiar, i cili zgjidh problemet financiare mes konsumatorit, Autoritetit dhe kompanive të sigurimit, nëpërmjet tribunaleve të ndryshme të formave të arbitrazhit pa përfshirë gjykatat. Pra, duke fituar kohë dhe kosto në proceset gjyqësore.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Përpara se t’ju lë të lirë, kam unë një pyetje. Ju iu referuat me të drejtë ngërçit mes bordit dhe institucionit. Të themi se për një moment e keni në dorë ta zgjidhni këtë ngërç, çfarë do të propozoni?

Olsi Çoku – Në fakt, problematika dhe ngërçi është krijuar ndër vite jo thjesht nga Byroja Kombëtare e Sigurimit dhe nga Fondi i Kompensimit, por edhe nga mosfunksionimi i disa hallkave që lidhen edhe me kompanitë e sigurimit. AMF-ja nuk ka ndjekur rolin e saj inspektues, por i ka marrë të mirëqena raportimet që kanë ardhur nga Byroja Kombëtare e Sigurimit, për efekt të shumave të kontribuara nga kompanitë e sigurimit. Duke bërë një inspektim tematik në këto dy institucione do të ishte ...

Arben Ahmetaj – Kam një pyetje të drejtpërdrejtë, dua të të provokoj në kuptimin e mirë të fjalës, a do ta ndryshonit strukturën e Byrosë?

Olsi Çoku – Për momentin më duhet ta studioj strukturën e Byrosë, sepse, duke mos qenë pjesë e sistemit, nuk dua të them diçka që mund të jetë e gabuar. Por duhet ndryshuar qasja, pra ndërveprimi institucional. Në Byro, ndoshta problematike nuk janë pozicionet apo shpërndarja e tyre mes kompanive dhe AMF-së dhe raportit mes tyre, por edhe mund të jenë, pra kjo duhet studiuar dhe duhet bërë një analizë e mirëfilltë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit për prezantimin, ishte shumë interesat. Është hera e dytë që prezantoheni me dinjitet në këtë komision.

Faleminderit!

Olsi Çoku – Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Edhe për zoti Pajtim është hera e dytë që vjen në komision.

Zoti Pajtim keni në dispozicion 5 deri në 7 minuta për të bërë prezantimin tuaj, duke iu referuar aplikimit.

Pajtim Melani – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Ka qenë nder dhe privilegj për mua të drejtoj bordin e AMF-së në fazën më të rëndësishme të procesit të konsolidimit të këtij institucioni të pavarur, në të gjithë kuptimet e konceptit jo vetëm ligjor, por edhe financiar dhe funksionimit institucional.

Dua të paraqes interesin tim për të mbështetur prioritetet e drejtimit të ardhshëm të bordit për rezultatet dhe arritjet e deritanishme.

Shkurtimisht, në 5 pika kryesore, arritjet e AMF-së në këtë periudhë kanë qenë:

Licencimi dhe miratimi i kuadrit rregullator për funksionimin e bursës së letër me vlerë, masat mbikëqyrëse dhe administrative në tregun e sigurimeve, zgjidhja e problematikave të mbartura që nga viti 2003 për Fondin e Kompensimit, revolucioni teknologjik në sistemin e policave të sigurimit *online* dhe zhdukja e policave falso.

Pika të reja janë: masat rregullatore për të siguruar transparencën dhe raportin e likuiditetit për fondet e investimit, të cilat në 3 vjet arritën në më shumë se 536 milionë euro asete, rritja në më shumë se 20% në vit të fondit të pensioneve private dhe dy strategji të miratuara dhe të vlerësuara nga partnerët ndërkombëtarë, strategjia e zhvillimit të sektorit financiar 2018-2022 dhe ajo për rritjen e edukimit financiar, në prezantimin e të cilave disa nga ju kanë qenë prezentë dhe për këtë ju falënderoj sërish!

Si kryetar i Bordit të AMF-së kam propozuar, përveç grupit për hartimin e strategjisë, edhe komitetin e kontrollit për ekzekutivin, duke pasur parasysh që AMF-ja, si institucion i pavarur, ka tre anëtarët e bordit si komitet *ad hoc* të kontrollit. Sigurisht, ne nuk mund të flasim aq drejt për veten sa flasim institucionet ndërkombëtare. Komisioni European në progresraportin më të fundit, atë të vitit 2018, e ka vlerësuar AMF-në në drejtim të funksionimit të plotë dhe eficient të bordit...

(Kryetari i komisionit ndërhyr pa mikrofon.)

FMN-ja ka vlerësuar që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare ka bërë një progres rrënjësor lidhur me përmirësimin dhe adoptimin e një kuadri të ri rregullator në lidhje me mbikëqyrjen e tregut, të kapitaleve dhe fondeve, duke përmendur *acquis*-në e rregulloreve të reja për të gjithë kuadrin nënligjor.

Ndërkohë, kemi realizuar me sukses katërmbëdhjetë pikat e rezolutës së Kuvendit për AMF-në, të cilat u përmendën edhe në takimin e së premtes të kryetarit të Kuvendit me institucionet e pavarura, nga të cilat 11 janë realizuar plotësisht, ndërsa 3 të tjerat janë në proces e sipër.

Për të qenë më konkretë dhe pa ju marrë shumë kohë, besoj se objektivat e drejtimit të bordit duhet të fokusohen në kthimin e një institucioni inovativ pro konsumatorit, më kredibël, më transparent dhe më llogaridhënës. Më konkretisht, jemi në procesin e hartimit legjislativ për sistemin bonus/malus, sigurimin e drejtpërdrejtë. Ndërkohë, Bordi i AMF-së ka miratuar në mbledhjen e datës 27 mars udhëzimin që ky vit të jetë vit zero në implementimin e një sistemi bonus/malus. Priten ndryshimet ligjore nga Ministria e Financave, Këshilli i Ministrave dhe më pas nga Kuvendi.

Projekti i Bankës Botërore, financiar nga Sekretariati për Zhvillimin Ekonomik i qeverisë zvicerane (SECO), ka konkluduar me sukses në hartimin e dy paketave ligjore: projektligjin “Për fondet e investimit” dhe atë “Për titujt”, të cilat besoj se do t’ju vijnë së shpejti në komision.

Ndërkohë, pas licencimit të regjistrimit shqiptar të titujve ALREG dhe plotësimit të kuadrit inovator për funksionimin e plotë të bursës, edhe me miratimin e Bankës së Shqipërisë, ne besojmë që bursa, përveçse ka transaksione të rëndësishme në tregun e letrave me vlerë, më shumë se 21 milionë euro, pritet që në vjeshtë të fillojë të listojë shitblerjet e aksioneve të shoqërive tregtare, pse jo edhe obligacionet e pushtetit vendor, ndërsa vitin e ardhshëm të listojë aksionet për shitje vlere.

Zhvillimi i kolonës së dytë “pensionet private”, sipas praktikave më të mira të ekonomive botërore, ka qenë një tjetër prioritet. Mbikëqyrja efiçente në tregjet financiare ka qenë gjithashtu risi për bordin këto kohë. Ne jemi në fazën kyçe të projekteve të reja të SECO-s dhe projekte të tjera të Bankës Botërore dhe FSVC-së për përmirësimin e cilësisë së raportit financiar për pjesëmarrjen në programin kombëtar të sigurimit nga katastrofat, ku është përgatitur një

projektiligj, që tashmë drejtimin e ka marrë Ministria e Brendshme, ashtu si edhe për përfshirjen në regjistrin *online* të shitjeve të disa produkteve të tjera të detyrueshme.

Me shumë rëndësi jemi fokusuar te sigurimi i minatorëve, që ka qenë një problem vitet e shkuara, por edhe sigurimi i ndërtesave të reja për një periudhë dhjetëvjeçare janë parashikuar në ligjin për të cilin po punohet me ministrinë në hartimin e akteve nënligjore.

Gjithashtu, jemi në procesin *screening* të të gjithë legjislacionit me direktivat e BE-së. Madje takimi i fundit javës që kaloi në Bruksel vlerësoi progresin e arritur.

Si përfundim, dua të shpreh bindjen, komision i nderuar, duke ju falënderuar për të gjithë vëmendjen, se do t'i jap hovin, ligjshmërinë dhe transparencën të gjithë procesit të përzgjedhjes për të vazhduar forcimin e kapaciteteve, pavarësisë dhe profesionalizmit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, si një nga dy rregullatorët më të rëndësishëm për tregjet financiare në Shqipëri.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Melani!

Ka ndonjë pyetje për zotin Melani? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Melani, për prezantimin tuaj!

Pajtim Melani – Faleminderit juve!

Arben Ahmetaj – Sipas procedurës, këtu mbaron edhe koha e prezantimit.

Pajtim Melani – Faleminderit! Mirupafshim!

Arben Ahmetaj – Të njoftohet kandidati tjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë, fokusohemi tani te zoti Mete.

Zoti Mete, faleminderit!

Koha në dispozicion për prezantimin tuaj është pesë deri në shtatë minuta.

Ervin Mete – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit, faleminderit për këtë mundësi dëgjese!

Praktikisht në pozicionet që unë kam mbajtur, si zëvendësministër i Financave apo zëvendësministër i Ekonomisë, kam pasur një ndërthurje dhe përfshirje thelbësore me çështjet që rregullojnë apo që janë në fushën e mbikëqyrjes së AMF-së.

Duke nisur që nga vetë ligji, që praktikisht rregullon AMF-në, ne kemi qenë të përfshirë dhe një pjesë e rëndësishme e anëtarëve të komisionit kanë qenë që atëherë kur, pas një raporti të

Bankës Botërore, që shqyrtonte sistemin financiar, e kemi riformuar institucionin, duke i dhënë atij pavarësi strukturore të pagave dhe organizative. Që aty praktikisht ka nisur forcimi i rolit të AMF-së, për të cilin ka pasur progres, por që ka nevojë të zhvillohet edhe më tutje për të arritur atë synim institucional që ka pasur dhe synojmë.

Para këtij komisioni, në pozicionet e mia si zëvendësministër i Financave, kam paraqitur dhe mbrojtur praktikisht një pjesë të konsiderueshme të ligjeve në fushën e mbikëqyrjes së AMF-së, siç është ligji “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, ligji “Për fondet e pensioneve vullnetare”...

Tani jemi në diskutim e sipër për ligjin “Për tregjet e kapitalit” ose atë “Për fondet e investimeve” dhe, siç e thashë, kam qenë thelbësisht i përfshirë në çështje rregullatore, që lidhen me Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare.

Më tej, në pozicionin e zëvendësministrit të Ekonomisë kam qenë i ngarkuar me procesin e privatizimit të kompanisë “INSIG”, edhe duke e drejtuar kompaninë për një periudhë kohore, proces i cili rezultoi i suksesshëm dhe tej pritshmërive, si dhe proces i cili më ka dhënë mundësi të jem i përfshirë edhe në detaje operationale të një prej fushave, në fakt, ndër më kryesoreve që mbulon AMF-ja, siç është ajo e sigurimeve. Pra, më ka dhënë mundësinë të kem një njohje të detajuar edhe të raporteve ndërmjet një të mbikëqyruri dhe institucionit.

Thënë kjo, nisur edhe nga eksperiencia në një institucion rregullator, siç është Ministria e Financave (tashmë Ministria e Financave dhe Ekonomisë), besoj që në pozicionin e kryetarit të bordit, i cili është një pozicion i jashtëm dhe kryesisht ka funksionin e ndërlidhjes, e ndërveprimit me institucionet e tjera dhe të mbikëqyrjes rregullatore të institucionit, do të jem në gjendje, kuptohet nëse marr besimin tuaj, ta çoj përpara idenë e forcimit të institucionit dhe dhënien e një roli qendror, që është nisur që me ndryshimet ligjore të periudhës 2013-2014 që kanë kaluar në këtë komision.

Për sa u përket kualifikimeve, dua të përmend këtu se jam anëtar i Bordit të Mbikëqyrjes së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, e cila ka pak a shumë të njëjtat kritere, madje në disa raste kërkesat për bordin e AMF-së janë edhe më kërkuese. Përgjithësisht, dokumentacioni është paraqitur.

Në momentin që po ju jap këtu, nga shërbimet e Kuvendit u ngrit një pyetje për angazhimin tim të dikurshëm partiak: unë kam drejtuar subjektin “G-99” nga viti 2012 deri në

vitin 2015, kur kam mbaruar mandatin dhe praktikisht është certifikuar me vendim gjykate. Nëse kjo do të jetë e nevojshme, do ta paraqes, por mendova se ishte një fakt i njohur.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Mete! Në këtë mënyrë ju i parapritë edhe pyetjes sime për angazhimin tuaj te “G99”-a.

Ervin Mete – Subjekti vazhdon, por unë prej tre vjetësh e gjysmë nuk jam në drejtim.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje?

Po, Ervin.

Ervin Bushati – Faleminderit për prezantimin shumë interesant!

Në fakt, unë jam i interesuar të di për kapitalizmin në përgjithësi të këtyre kompanive. Pra, ne kemi një sistem financiar dhe bankar të akredituar shumë mirë, shumë të besueshëm dhe kjo është një pikat e forta të ekonomisë në Shqipëri. Çfarë njohurish keni për këtë sektor? Si ta bëjmë atë sa më të sigurt që të rritim kredibilitetin e qytetarëve në një industri të tillë parabankare, që është shumë e rëndësishme për stabilitetin financiar, por edhe për marrëdhëniet e tij të përditshme?

Arben Ahmetaj – Parabankare apo jobankare quhet?

Ervin Bushati – Parabankare.

Ervin Mete – Faleminderit për pyetjen!

Besoj se i referoheni kapitalit të kompanive të sigurimeve, sepse aty janë fondet e investimeve, fondet e pensioneve?

Ervin Bushati – Jo vetëm, por për çdo gjë që mbulon AMF-ja.

Ervin Mete – Nga informacioni që kam, përgjithësisht për plotësimin adekuat të nevojës për kapital ka pasur vetëm te kompanitë e sigurimeve. Kjo për faktin se ato kanë një natyrë të veçantë biznesi, ku, në varësi të dëmeve që akumulojnë dhe vlerësimit aktuaristik, bazuar edhe mbi teknologjitë respektive, duhet të plotësojnë kapital herë pas herë, në mënyrë që të përballojnë detyrimet. E njoh me detaje këtë çështje, sepse ne jemi përballur me këtë problematikë tek INSIG-u dhe na është dashur ta amortizojmë dhe ta plotësojmë jo vetëm në Shqipëri, por edhe në dy autoritetet e tjera mbikëqyrëse, siç ishte Banka Qendrore e Kosovës, ku INSIG-u kishte degë dhe AMF-ja e Maqedonisë, ku INSIG-u kishte filial, në fakt, edhe me një

vendimmarrje shumë të kthjellët nga kryetari i komisionit, që ishte ministër i Ekonomisë, aksioner i kompanisë, për shkak të tagrit si përfaqësues i shtetit...

(Diskutime pa mikrofon)

Unë i konsideroj fakte të ditura këto, Ministër...

(Diskutime pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Ka një pyetje zonja Blerina.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, zoti Mete për prezantimin!

Mendoj se duhej t'i kishim lënë pak më shumë kohë zotit Mete për prezantimin. Kandidatët e tjerë patëm mundësi t'i dëgjonim më shumë, kështu që duhej t'i kishim lënë më shumë kohë në dispozicion.

Pyetja ime: çdokush që kandidon, vjen me platformën se çfarë do të donte të ndryshonte, më pas problematikat që hasen në institucion bëjnë që shpeshherë të mos ndiqet asgjë, ose pak nga ajo që është paraqitur në këtë komision, në rastin tuaj, zoti Mete, çfarë do të donit të ndryshonit në atë institucion, duke parë nga jashtë që nuk funksionon? Nëse shkoni atje, cili do të ishte qëndrimi për situata, të cilat janë problematike, sidomos në tregun e sigurimeve?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, zoti Mete.

Ervin Mete – Faleminderit për pyetjet!

Në fakt, për sa u përket objektivave, unë nuk do t'i quaj ndryshime thelbësore, por avancime të një progresi, që ka nisur me një analizë të detajuar në 2013-2014 dhe më ndërhyrjet thelbësore ligjore që ne kemi bërë qoftë për pavarësinë institucionale, qoftë për avancime ligjore dhe implementim direktivash në fushat respektive të mbulimit, por që kanë nevojë të avancohen më tej.

Do të veçoj ligjin për tregjet e kapitalit, i cili në 2-3 muajt e ardhshëm do të vijë në këtë komision. Po punohet prej 1 viti e gjysmë me një ekip të Bankës Botërore dhe besoj se do të zhvillojë një segment, i cili këtu te ne është i pazhvilluar dhe ka një format që përfron direktivën e BE-së dhe do ta zhvillojë në një format modern të mirëformatuar apo të mirëstrukturuar.

Zhvillimi i dytë lidhet me linjën e fondeve të investimeve. Pavarësisht se problematika më e madhe atje është te kompanitë e sigurimeve, fondet e investimeve janë ato që kanë peshën më të madhe për sa u përket fondeve të akumuluar. Megjithëse se deri tani kanë qenë të mirëmenaxhuara dhe me risqe të kontrolluara, duan një vëmendje shtesë për peshën që paraqesin

për sa i përket mbikëqyrjes në institucion. Në kompanitë e sigurimeve besoj se ka nevojë të përmirësohet raporti i mbulimit të dëmeve (ky është një ndër veprimet kryesore që ka autoriteti me kompanitë e sigurimeve); të reduktohet disi pjesa e shpenzimeve operacionale, pra ato që shkojnë për marketing etj., në mënyrë që të sigurohet një besueshmëri më e madhe e të siguruarve në një treg, pra shteti u ka dhënë mandatin kompanive të sigurimeve për të mbledhur sigurimet e detyrueshme. Sigurisht, krahas tij do të duhet të zhvillohen edhe të gjitha linjat e sigurimeve vullnetare që janë pak të zhvilluara sot, por që është në përgjegjësinë kryesisht të kompanive, por edhe të autoritetit të zhvillojnë veçanërisht linja të përgjegjësisë profesionale apo sigurimit në përgjegjësinë profesionale, siç mund të jenë mjekët apo profesionet e caktuara, të cilat mbartin njëfarë rreziku dhe në përgjithësi kanë nevojë për një mbikëqyrje me sens zhvillimor, pra jo mbikëqyrje me sens ngushtues apo ndëshkues, por ka nevojë për një tango midis të mbikëqyrurve dhe mbikëqyrësit për të zhvilluar institucionet.

E treta, duhet të këtë një komunikim më të mirë, një rol më të mirë të institucionit për iniciativat që merr dhe përgjegjësisë që ka ndaj publikut, sepse është një institucion në mbrojtje të interesave të publikut mbikëqyrës ndaj subjekteve të mbikëqyrura.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Po, Senida.

Senida Mesi – Përshëndetje, zoti Mete!

Ju falënderoj për prezantimin! Sigurisht, pas një eksperience të gjatë në fushën e financave dhe ekonomisë, duke iu referuar edhe CV-së suaj dhe prezantimit, pa dyshim që platforma juaj nesër do t'i jepte një dinamikë tjetër AMF-së.

Pyetja direkte: duke pasur parasysh që ne si Kuvend duhet të ruajmë pavarësinë e institucioneve dhe duke pasur parasysh që AMF-ja është një institucion i pavarur, sa do të ruhet kjo pavarësi? Si e gjykoni, nisur nga fakti që keni mbajtur pozicione drejtuese në ekzekutiv apo shef kabineti në Ministrinë e Financave, a ka konflikt interesi dhe a cenohet pavarësia e institucionit e AMF-së nëse ju do të jeni fituesi i këtij vendi, për të cilin keni aplikuar?

Pyetja tjetër lidhet me kriteret e kandidimit. Një nga kriteret e kandidimit për kryetar bordi të AMF-së është që nuk duhet të jetë anëtar në më shumë se në një bord tjetër. Sa i gatshëm jeni ju për të dhënë dorëheqjen nga anëtarësitë e tjera të bordit?

Faleminderit!

Ervin Mete -Faleminderit për pyetjen!

Pozicioni i anëtarit të bordit dhe dy anëtarëve të tjerë është një pozicion i jashtëm në AMF dhe praktikisht ligji shprehet se është e lejuar të mbajë pozicione të tjera me kohë të plotë. Pra, mënyra sesi është strukturuar bordi i AMF-së, ku vetëm drejtori ekzekutiv dhe nëndrejtori i AMF-së mbajnë pozicione me kohë të plotë në institucion, ndërsa tre anëtarët e tjerë, një nga Banka e Shqipërisë dhe një i propozuar nga Komisioni i Ligjeve janë me kohë të pjesshme dhe shprehimisht ligji lejon që të mbajnë pozicione të tjera. Kështu kanë qenë rastet në vazhdimësi të anëtarëve dhe kështu është rasti i anëtarit të Bankës së Shqipërisë, i cili ka qenë dhe është. Kështu ka qenë edhe rasti i zotit Melani, që aktualisht është kryetar dhe punonjës te AKEP-i. Pra, praktikisht nuk ka konflikt ligjor me një punësim tjetër. Megjithatë, kjo është ende në fazë aplikimi dhe për aplikimin nuk kërkohet të ketë distanca nga institucione të tjera.

Lidhur me pyetjen e dytë, unë e kam paraqitur edhe në dokumentacionin shkresor pranë komisionit që jam anëtar i ASD-së, sepse ligji shprehet që nuk mund të jetë anëtar i më shumë se një bordi tjetër mbikëqyrës, pra që ka funksione mbikëqyrëse, domethënë jo më shumë se 1.

Arben Ahmetaj – Në total janë 2.

Ervin Mete- ...që do të thotë se, sipas ligjit, nuk lejohet që të jenë më shumë se 2. Dua të theksoj se ky është një pozicion i jashtëm dhe paraqitet vetëm për mbledhjet e bordit dhe, siç e kam deklaruar edhe në dokumentacion, nuk jam më shumë se në një bord tjetër mbikëqyrës.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Fjala për Antoneta Dhimën.

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Mete, për prezantimin!

Duke pasur parasysh eksperiencën tuaj si drejtues pranë Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, kam dy pyetje.

Pyetja e parë, cili është opinionin tuaj për mënyrën e funksionimit të institucionit të AMF-së?

Pyetja e dytë, a mendoni ju që duhet të ketë ndryshime në ligjin për AMF-në dhe ku konkretisht?

Faleminderit!

Ervin Mete – Faleminderit për pyetjet!

Po e nis përgjigjen time nga pyetja e dytë, në mënyrë që t'i përgjigjem edhe të parës. Ligji për funksionimin e Autoritetit, siç ju thashë, së bashku me Bankën Botërore, pas një analize

të detajuar të funksionaliteteve që duhet të mbulonte AMF-ja dhe pavarësisë së shtuar që synohet t'i jepej institucionit për të realizuar funksionet e veta, është riformatuar në vitet 2013-2014.

Në këndvështrimin tim, ligji e ka përmbushur mirë funksionin e tij, ky është opinion personal, dhe nuk shoh një nevojë për ndryshim imediat në ligjin e funksionimit të Autoritetit. Atje ku ka nevojë për ndryshime janë ligjet sektoriale, ato të fushave që mbulon Autoriteti, të cilat duhet të riformatohen, modernizohen dhe të jenë në linjë edhe me direktivat europiane.

Për sa i përket mënyrës së funksionimit të Autoritetit, mendoj që ka pasur disa progres në përqaftimin e kësaj pavarësie, që ka synuar t'i japë pikërisht ndryshimi ligjor dhe riformatimi i institucionit, por ka nevojë të zhvillohet më tej, në mënyrë që të ketë këtë pavarësi dhe rol qendror në mbikëqyrjen e institucionit, por edhe si staturë institucionale, në raport me institucionet e tjera, të plotë dhe të mirërealizuar.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zoti Xhevit Bushaj.

Xhevit Bushaj – Kam një pyetje lidhur me konkurrimin që ju bëni sot për kryetar bordi të AMF-së. Në qoftë se ju do të ishit dakord për shoqëritë e sigurimeve për produktet që ato ofrojnë te qytetarët, konkretisht për sigurimin në bujqësi, sidomos ambienteve të mbrojtura, ose serrave, që kanë një primë të lartë sigurimi, ku në pjesën më të madhe fermerëve shqiptarë nuk u ofrohet ky produkt, domethënë nuk kryhet sigurimi i serrave apo produkteve bujqësore, si mund ta zgjidhni këtë problem nëse ju do të zgjidheni në krye të institucionit?

Arben Ahmet – Megjithëse është pyetje për zotin Mete, unë ju them se ky produkt ofrohet.

Xhevit Bushaj – Zoti Kryetar, e thashë edhe unë që ofrohet, por me një primë të lartë sigurimi, që fermerët e kanë të papërballueshme.

Ervin Mete – Siç e përmendi edhe kryetari, është një produkt që ofrohet dhe tregjet e tjera e kanë më të zhvilluar sesa në sigurimin në bujqësi, por që është një produkt sigurimi me risk shumë të lartë dhe praktikisht primi që përgjithësisht aplikohet sot lidhet me riskun që mbart subjekti apo veprimtaria. Maqedonia e ka pasur më të zhvilluar sesa ne, por edhe ata kanë hasur në çështje me risqe shumë të larta, të cilat kanë përfunduar në gjykatë. Sigurisht që duhet zhvilluar si produkt, por në kombinim edhe me zhvillimin e sektorit, në mënyrë që sektori të jetë

më produktiv dhe të amortizojë risqet, në mënyrë që primi që paguhet për policat të jetë më i përballueshëm.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Xhevit Bushaj – A nuk mund të jetë edhe me pjesëmarrje, qoftë edhe me fonde të buxhetit, qeverisë apo të donatorëve krijimi i një produkti të përbashkët?

Arben Ahmetaj – Më fal, pyetja është nëse do të ketë një produkt të ri me subvencionim nga buxheti?

Xhevit Bushaj- Po.

Arben Ahmetaj – Po, zoti Mete.

Ervin Mete – Mendoj se kjo lloj pyetjeje del jashtë fokusit të vetëm të AMF-së, sepse është një politikë zhvillimore që duhet diskutuar në formacione më të gjera, qoftë me qeverinë, qoftë me donatorë zhvillimi, më pas AMF-ja do të jetë mbikëqyrësi i zhvillimit në treg. Praktikisht nuk është në fokusin e AMF-së, është thjesht mbikëqyrja tregut dhe jo....

Arben Ahmetaj – Zoti Mete, mund të dilni nga kostumi i aplikantit në një moment dhe të ktheni përgjigje për pyetjen që bëri zoti...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, a do të ishit ju për një produkt të subvencionuar nga buxheti i shtetit?

Ervin Mete – Zoti kryetar, kjo kërkon një përlllogaritje shumë më të detajuar se kaq.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A ka ndonjë pyetje tjetër për zotin Mete? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Mete, për prezantimin tuaj!

Ervin Mete – Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Përpara se të vazhdojmë diskutimin zyrtar, dua të bëj një konsultë 5 minuta me pjesën e pozitës. Zoti Elezi ose do të na falni, ose të dalim të gjithë që të bëjmë një konsultë.

Zoti Elezi vetëm ju jeni nga opozita? Mirë se erdhët!

Arben Elezi – Mirë se ju gjeta!

Arben Ahmetaj – Me mirëkuptimin tuaj do të donim të na linit 3 minuta vetëm, sepse duam të bëjmë një konsultë jozyrtare ose dalim të gjithë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit, e vlerësoj shumë!

(Rifillon mbledhja)

Arben Ahmetaj - Unë po flas në emër të pjesës së maxhorancës, më pas zoti Elezi të mbajë një qëndrim personal në emër të Partisë Demokratike apo në emër të të gjithë opozitës, është çështje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jeni të pavarur, në rregull.

Unë po bëj një përmbledhje të konkluzioneve, duke shqyrtuar të tria aplikimet, të gjithë materien brenda aplikimeve dhe përmbushjen e kushteve ligjore për të qenë kryetar të AMF-së.

Ne i vlerësojmë të 3 kandidaturat të kalueshme në bazë të ligjit dhe më pas, duke iu referuar eksperiencës profesionale më duhet të them se të 3 kandidaturat janë në nivelin e ekselencës, njëra më e gjetur se tjetra. Besoj se është një shenjë shumë e mirë që një cilësi e tillë më në fund ka filluar të afrohet në institucione serioze, aq më tepër si institucionet e mbikëqyrjes së sistemit jobankar. Ndërkohë, jemi në fazë shumë të rëndësishme, atë të reformimit të sistemit, pra të fillimit të punës për shtyllën e dytë, ku kujdesi, risqet dhe teknikalitetet vijnë dhe bëhen gjithmonë e më të detajueshme, të debatueshme dhe të rëndësishme.

Ne mendojmë se kandidatura e zotit Ervin Mete dhe 3 kandidaturat që plotësojnë kushtet në këndvështrimin tonë është më e plotë. Zoti Ervin Mete ka marrë pjesë në hartimin e ligjit në vitin 2014, ka marrë pjesë në procesin e privatizimit të INSIG-ut në vitin 2015, ka marrë pjesë në reformën e sektorit financiar, madje në emër të ministrit të Financave, ka qenë liazon i grupit të përbashkët qeveri-Bankë e Shqipërisë për të gjithë reformën. Pjesa e pozitës mendon që kandidatura e zotit Ervin Mete të mbështetet si kandidaturë për t'u votuar në seancë.

Këtu po e mbyll pjesën e konkluzioneve të mia dhe ftoj zotin Elezi që të thotë qëndrimin e tij për të tria kandidaturat.

Arben Elezi – Unë nuk mund të votoj asnjërin, sepse nuk jam thelluar në dokumentacion, prandaj do të abstenoj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për të 3 abstenoj.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Kush është dakord me kandidaturën e zotit Ervin Mete? Kundër?

Abstenim?

Miratohet.

Mendoj që për kandidaturat e tjera të pozicionohemi në abstenim? Në rregull.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar

Anastas Angjeli

**Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili**

Sekretar i komisionit

Elvi Prifti